



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 166/1 Prot.

Tiranë, më 03.03.2015

VENDIM

Nr. 20, datë 03/3/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr.166 Prot., datë 24.02.2015, ndaj Autoritetit Publik/Rektorati i Universitetit të Tiranës, me objekt “Refuzim për dhënie informacioni” sipas së cilës pretendon se është cënuar në të drejtën e tij për informim.

Ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 24/1/2/b të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, z. në datë 13.01.2015 ka paraqitur pranë autoritetit publik/Rektoratit të Universitetit të Tiranës, kërkesën për informacion. Nëpërmjet saj kërkuesi ka kërkuar ti vihen në dispozicion kopje të dokumenteve zyrtare, konkretisht:

1. Një kopje të dokumenteve të ardhura nga komisioni i Fakultetit të Shkencave të Natyrës me vlerësimin e kandidatëve për vendin e profesorit të kimisë pranë këtij fakulteti
2. Vendimin për përzgjedhjen e kandidatit fitues

Nga dokumentacioni bashkëlidhur ankesës rezulton se, kërkesa është trajtuar brenda afatit ligjor, konform nenit 15/1 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nga autoriteti publik/Rektorati i Universitetit të Tiranës. Në përgjigjen e dhënë Autoriteti Publik/Rektorati i Universitetit të Tiranës, ka argumentuar se dosjet e kandidatëve dhe vlerësimet e tyre përmbajnë të dhëna personale dhe janë grumbulluar vetëm për qëllim të zhvillimit të konkursit për staf akademik dhe si të tilla nuk mund të përpunohen për qëllime të tjera në referim të përcaktimeve të nenit 5 pika 1 gërma “d” dhe nenit 6 pika 1 gërma “a” të ligjit 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, por shkatërrohen me përfundimin e procedurës së

ankimimit ndaj renditjes dhe fituesit të shpallur. Lidhur me kandidatin fitues, në portalin www.fshn.edu.al gjenden emrat e stafit akademik.

Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik i është përgjigjur konform ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, sa i përket kopjeve të dokumenteve të ardhura nga komisioni i Fakultetit të Shkencave të Natyrës si dhe vlerësimit të kandidatëve për vendin e profesorit të kimisë pranë këtij fakulteti.

Komisioneri bazuar në nenin 24/3 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, me qëllim verifikimin e këtyre fakteve, aksesoi në faqen zyrtare të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në të cilën rezultoi se informacioni që duhet të bëhet publik nuk është mundësuar si i tillë. Pas vlerësimit të ankesës së _____ dhe përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, Komisioneri

konstaton se, kërkesa për vendimin e rektorit për përzgjedhjen e kandidatit fitues, është informacion që bën pjesë në kategorinë e informacionit publik, sipas pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe si i tillë i duhet vënë në dispozicion kërkuarit.

Në përfundim, në lidhje me ankesën e _____ ndaj Rektoratit të Universiteti të Tiranës, Komisioneri vlerëson se, ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës nr. 166 Prot., datë 24.02.2015 të _____
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Rektoratit të Universitetit të Tiranës për të dhënë dokumentacionin, konkretisht, Vendimin e Rektorit për përzgjedhjen e kandidatit fitues brenda datës 16.03.2015.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 03.03.2015.

